



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj – Sheremeti dhe Franciska Zhitija - Ymeri, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - konfliktin administrativ sipas propozuesit – paditësit “NPN Intercorn M shok me seli ne Ferizaj, kundër kundërshtares se propozimit - të paditurës Administrata Tatimore e Kosoves, me seli në Prishtinë, me bazë juridike për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, nr.574/23, datë 16.01.2024, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit - propozuesit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Administrativ KF.nr.101/24, të datës 20.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesit – paditësit “NPN Intercorn M shok me seli ne Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Administrativ KF.nr.101/24, të datës 20.02.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Fiskal, në pikën I të dispozitivit është refuzuar propozimi- kërkesa e “NPN Intercorn M shok me seli ne Ferizaj, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të aktit administrativ përfundimtar- vendimit me nr.574/23, datë 16.01.2024të të paditurit, Administrata Tatimore e Kosovës. Në pikën II të dispozitivit është caktuar se procedura sipas padisë në këtë konflikt administrativ do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës në konfliktin administrativ dhe sipas planit të punës së Gjykatës.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, propozuesi – paditësi “NPN Intercorn M shok me seli ne Ferizaj, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e kontestuar ta ndryshon dhe të aprovojë kërkesën në tërësi kërkesëpadinë e propozuesit – paditësit “NPN Intercorn M shok me seli ne Ferizaj.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së kunderpropozuesit-te paditurës, kolegji i kësaj gjykate, gjen se Dhomat e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me nr.574/2023, datë 16.01.2024 të Administratës Tatimore të Kosovës, ka gjetur se propozimi i tillë është i pabazuar, ngase paditësi nuk e ka bërë të besueshme përmes provave të prezantuara, nuk ka arritur të vërtetoj se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm, si dhe se ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues, ashtu siç është përcaktuar në nenin 22, paragrafi 6 e lidhur me paragrafin 2, të këtij neni, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA).

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një konkludim të tillë të gjykatës së shkallës së parë ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par. 6 lidhur me par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se: “me kërkesë e paditësit, organi akt i te cilit ekzekutohet gjegjësisht organi qe është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri ne vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do ti sillte dem paditësit, i cili vështir do te riparohej, kurse shtyrja nuk është ne kundërshtim me interesin publik, as qe shtyrja do ti sjellte ndonjë dem te madhe palës kundërshtare përkatësisht personit te interesuar”.

Gjykata e Shkalles se pare ne vendimin e saj, ka konstatuar se paditësja ne pretendimet e saja nuk i ka arsyetuar mjaftueshëm se të njëjtat janë të bazuara në Ligj dhe se ne rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet Ligjore qe te aprovohet propozimi për shtyrje te ekzekutimit te vendimit deri sa gjykata te vendos përfundimisht lidhur me Ligjshmërinë e vendimit te kontestuar përkitazi me padinë e paditësit e ne kuptim te nenit 22 te LKA-se.

Me që nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës rezulton se me vendimin nr. 574/23, datë 16.01.2024 Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, këtu propozuesit, i është refuzuar si e pabazuar ankesa dhe njoftim rivlerësimet e tatimit shtese nga kontrolli janë vërtetuar si te bazuara si dhe ne piken e dyte te dispozitivit te vendimit te atakuar është konstatuar se procedura e ankesës nuk e ndërprejnë obligimin e tatimpaguesit për pagese te detyrimeve tatimore.

Me tej nga shkresat e lendes rezulton se këtu pala propozuese ka parashtruar ankese ndaj raportit te kontrollit, ku pas kontrollit te realizuar nga e paditura te pala paditëse janë përcaktuar borxhe (detyrime tatimore, ndëshkime dhe interes i pashlyer).

Pala propozuese ne pretendimet e saja thekson se është ne pamundësi te përmbushjes se detyrimit, pasi qe kjo do te i krijoj vështirësi financiare, duke i shkaktuar humbje te pariparueshëm, ka kërkuar mbrojtje gjyqësore si ne petitum te kërkesës.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të propozueses- paditëses, në ankesë të cekura më lartë ndaj aktvendimit të shkallës së parë se me ekzekutimin e vendimit të atakuar do të i shkaktohet dëme i pariparueshëm propozuesit dhe për faktin se shtyrja e ekzekutimit te vendimit nuk është ne kundërshtim me interesin publik kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa.

Derisa pretendimet ne padi dhe përgjigje ne ankese te palës paditëse, me te cilat është kërkuar caktimi i masës së përkohshme për shtyrjen të ekzekutimit të aktit administrativ, të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit nuk janë të bazuara dhe se vlerësimi i kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit siç parashihet në nenin 6 dhe 22 par.2 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale dhe nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e mos caktimit te masës se përkohshme dhe shtyrjes se ekzekutimit te vendimit dhe se pretendimet ankimore janë të pa ndikim për vendosje në mënyrë tjetër, andaj ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË
Kom.Dh.Shk.II.nr.709/234, me datë 25.03.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Faton Bajrami, d.v